



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

NJOFTIM PËR MEDIAT

Mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve në oferta në Prokurimet Publike

Komisioni i Konkurrencës, ka marrë një vendim për të dhënë disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike. Në bazë të këtij vendimi Autoriteti i Konkurrencës ka rekomanduar ndryshimin dhe shtimin e disa akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimeve publike. Këto ndryshime synojnë që të ndërgjegjësojnë në radhë të parë vetë ndërmarrjet që të mos hyjnë në marrëveshje të ndaluara në oferta në prokurimet publike dhe në radhë të dytë të sqarojë rolin e zyrtarëve të prokurimeve në rast se konstatojnë shenja të marrëveshjeve të tilla ti raportojnë pranë Autoritetit të konkurrencës.

Marrëveshjeve në oferta në Prokurimet Publike ndodhin kur ndërmarrjet (operatorët ekonomikë), të cilët pritet të konkurrojnë, në mënyrë të fshehtë bien dakord për rritjen e çmimeve, ndarjen e tregjeve ose uljen e cilësisë së mallrave apo shërbimeve për blerësit, të cilët dëshirojnë të sigurojnë produktet dhe shërbimet nëpërmjet një procesi prokurimi.

Marrëveshje të tilla janë shumë të dëmshme pasi një proces konkurrues mund të sigurojë çmime të ulëta, cilësi më të mirë dhe risi, vetëm nëse ndërmarrjet (operatorët ekonomikë) konkurrojnë me të vërtetë, duke i vendosur kushtet dhe kriteret e tyre me ndershmëri dhe në mënyrë të pavarur. Këto marrëveshje sjellin pasoja për blerësit dhe taksapaguesit, ulin besimin publik në një proces konkurrues dhe zvogëlojnë përfitimet nga një treg konkurrues.

Bazuar në nenin 4 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” marrëveshjet në oferta janë marrëveshje të ndaluara, pasi ato kufizojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” vendosi ti rekomandoje Agjencisë së Prokurimit Publik, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë:

1. Amendimin e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 13, pika 3, sipas se cilës APP përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e

prokurimit për një periudhe 1-3 vjet për rastet e propozuara sipas germave a, b,c, ç te kësaj pike, ku te shtohet, germa d, me përmbajtje si vijon:

“d) Për rastet kur me Vendim te Komisionit te Konkurrencës është zbuluar ekzistenca e një marrëveshje ne oferta midis operatoreve ekonomike pjesëmarrës ne procedurat e prokurimeve” .

2. Në kuadrin ligjor të fushës së Prokurimeve Publike, të parashikohen procedurat që mbulojnë raste kur Autoriteteve Kontraktore u lind përgjegjësia për të njoftuar Autoritetin e Konkurrencës, në rastet kur gjatë projektimit dhe/ose zhvillimit të procedurave të prokurimit vihen re shenja të marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike. Në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës të formulohet një kre i veçantë në VKM nr. 1 “Për rregullat e prokurimit publik” (ose në çfarëdo lloj akti tjetër ligjor që konsiderohet i përshtatshëm) në të cilin të përcaktohen rastet e mësipërme.

Gjithashtu Autoriteti I Konkurrencës vendosi ti rekomandojë Agjencisë se Prokurimit Publik:

1. Përfshirjen ne dokumentet standarde të tenderit të certifikatës për oferte te pavarur.
2. Hartimi i një Udhëzuesi të përbashkët për luftimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike.
3. Hartimi i Guidës “Mbi zbulimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike dhe për të reduktuar marrëveshjet në oferta në prokurimet publike”, si dhe Flet-Palosjes “Për sinjalet e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike”.
4. Bashkëpunimin për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit mbi rëndësinë e zbulimit dhe parandalimit të marrëveshjeve në oferta, mënyrat dhe mjetet e luftimit të këtyre marrëveshjeve me pasoja mjaft të rënda për konkurrencën, taksapaguesit dhe vetë buxhetin e shtetit.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi i vazhdueshëm midis APP dhe AK është i domosdoshëm me qëllim rritjen e konkurrencës dhe eficientës së prokurimeve publike; parandalimin e marrëveshjeve ne oferta ne prokurimet publike; ndërgjegjësimin e bizneseve dhe publikut për luftimin e marrëveshjeve në oferta; ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve në tenderë për pasojat e marrëveshjeve ne oferta; zbulimin dhe raportimin e shkeljeve të rasteve të mundshme në procedurat e prokurimit. Ky bashkëpunim midis institucioneve ka qenë I shkëlqyer dhe të do të intensifikohet në të ardhmen me qëllim zbatimin e rekomandimeve të sipër përmendura të AK.

Për më shumë informacion, gjeni të publikuar të plotë vendimin e Komisionit të Konkurrencës në faqet zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës www.caa.gov.al në seksionin “Vendime”.